

LIGJI Nr. 06/L -025

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-225 PËR PROKURORIN E SHTETIT I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 05/L-034

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-225 PËR PROKURORIN E SHTETIT I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-034

Neni 1

Pas nenit 12/A të ligjit bazik, shtohet neni i ri 12/B, me tekstin si në vijim:

Neni 12/B

Për kryerjen e përgjegjësive të tyre, çdo prokurorë duhet të ketë së paku nga një bashkëpunëtor profesional

Neni 2

Neni 20 i Ligjit bazik, nënparagrafët 4.1 dhe 4.3, riformulohen me tekstin si në vijim:

4.1. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë mandat të përhershëm si prokuror dhe vlerësim pozitiv të performancës;

4.3. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, prokurori duhet t'i plotësojë kushtet për të punuar si prokurorë në Departamentin për Krime të Rënda, si dhe të ketë vlerësimin pozitiv të performancës. Periudha e ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë Speciale, të caktuar sipas dispozitave të këtij Ligji, llogaritet si përvojë e prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore.

Neni 3

Neni 25, i Ligjit bazik, riformulohet si vijon:

Neni 25

Veprimtaritë profesionale

1. Prokurori me aprovim paraprak të Kryeprokurorit të Prokurorisë, ndërsa Kryeprokurorët e Prokurorive, me aprovimin paraprak të Këshillit, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të prokurorëve.

2. Prokurori me aprovimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë dhe Kryeprokurorët e Prokurorive me aprovim të Këshillit, vetëm jashtë orarit të punës, marrin pjesë në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe sjelljen profesionale të prokurorëve.

3. Në pajtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve, prokurorët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve prokuroriale gjatë apo pas përfundimit të funksionit prokurorial, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor, të lëshuar nga Këshilli.

4. Prokurorët dhe Kryeprokurorët, për aktivitetet e parapara në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej njëzetepesë (25%) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim prokurorët e njoftojnë Kryeprokurorin, kurse Kryeprokurorët e njoftojnë Këshillin.

Neni 4

Neni 32/A i Ligjit bazik, paragrafi 2, fshihet

Neni 5

Pas nenint 32/A të ligjit bazik, shtohet nen i ri 32/B me tekstin si në vijim:

Neni 32/B

Emërtimi "Instituti Gjyqësor i Kosovës", i përcaktuar në Ligjin nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit si dhe Ligjin nr. 05/L-034 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-225, zëvendësohet me emërtimin "Akademia e Drejtësisë".

Neni 6 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -025
30 mars 2018

Shpallur me dekretin Nr. DL-007-2018, datë 17.04.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi